


Promovimi i Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme në Kosovë

Përmbledhje Ekzekutive



Promovimi i Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme në Kosovë

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i Qëndrueshëm**

Publikimi: **Nëntor, 2020**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) mbështetur nga GIZ. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Implemented by
giz German Development Cooperation (GIZ) GmbH

Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Shënim:

Ky punim është shkruar në gjuhën shqipe fillimisht.

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	4
1. EE-ja në Kosovë – Skemat e Obligueshme për Efiçencë të Energjisë	5
2. Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë i Kosovës	7
3. BRE-të në Kosovë – Ulja e TVSH-së për energji solare	10

1. Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore është institut kërkimor i llojit think-tank dhe qendër avokimi e themeluar në vitin 2011 me qëllim ofrimin e zgjidhjeve të pavarura dhe strategjike të politikave, bazuar në hulumtime të besueshme. Misioni ynë është fuqizimi dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm socio-politik dhe ekonomik bazuar në parimet dhe vlerat demokratike, mundësive të barabarta, drejtësisë sociale dhe mjedisore dhe të drejtave të njeriut.

Nga themelimi ynë e deri tash, INDEP ka cementuar statusin si një nga akterët më të rëndësishëm të shoqërisë civile në procesin e politikëbërjes në Kosovë. Kjo ka ardhur si rezultat i punës sonë të paanshme, cilësisë së publikimeve tona dhe shtrirjes së gjerë të rrjetit tonë bashkëpunues me shumë institucione vendore dhe të jashtme, dhe organizata partnere. Puna jonë zhvillohet në 3 programe kryesore:

1. Zhvillim i qëndrueshëm,
2. Qeverisje demokratike, si dhe
3. Bashkëpunim rajonal.

Brenda këtyre tri programe, INDEP ka publikuar më shumë se 75 hulumtime dhe implementuar rreth 40 projekte lokale dhe regjionale. Në të njejtën kohë kur është themeluar INDEP-i, ka filluar edhe angazhimi ynë në fushën e enegjisë. INDEP është eksperti i energjisë në Kosovë, me theks të veçantë në eficiencyn e energjisë (EE) dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE). INDEP në vitin 2012 ka konsoliduar bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës, në veçanti me Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (KZhEITI), tash Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike (KEPTINIS). INDEP që prej fillimit të bashkëpunimit me Komisionin ka asistuar Komisionin në formulimin e politikave zhvillimore efikase, të qëndrueshme dhe transparente, kemi marrë pjesë në Grupin Punues për Ndryshimin e Ligjit për Eficiencyn e Energjisë, kemi qenë pjesë e grupit punues për hartimin e ligjit të ri të Kosovës për Performancën e Energjisë në Ndërtesa, kemi punuar në fushata të ndërgjegjësimit dhe kemi implementuar projekte si pjesë e të cilave kemi informuar qytetarët dhe bizneset për rëndësinë e zbatimit të masave të eficiencys së energjisë, kemi shpërndarë skema të granteve të biznesit të vogël dhe të mesëm për zbatimin e masave të eficiencys së energjisë, dhe i kemi bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të krijojë Fondin e Eficiencys së Energjisë.

Përfaqësuesit e INDEP ulen në dy grupe punuese si pjesë e procesit të hartimit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, përkatësisht grupit të punës për Eficiencyn e Energjisë dhe atij për BRE, si dhe jemi një nga organizatat partnere të ekipit kryesor përgjegjës për organizimin e Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës, si formati i vetëm në Kosovë që organizohet nga 2 Ministri, 2 donatorë të huaj dhe organizata të shoqërisë civile.

Bazuar në të mësipërmet, INDEP-i ka implementuar projektin “Promovimi i Efiçencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme në Kosovë”, mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Efiçencë të Energjisë. Në kuadër të këtij projekti, INDEP ka publikuar 5 Hulumtime të pavarura lidhur me EE-të dhe BRE-të, të cilat janë:

- 1) Gjendja aktuale dhe praktikat e mira për implementimin e skemave obligative për efiçencën e energjisë dhe masat alternative,
- 2) Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë – Praktikrat dhe mjetet më të mira për një rol transformues,
- 3) Ulja e TVSH-së për investimet në energji solare fotovoltaike dhe prodhimin e decentralizuar,
- 4) Akterët dhe hartimi i politikave për zbatimin efektiv të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë të Kosovës,
- 5) Përfitimi nga efiçenca e energjisë nga sektori rezidencial, si dhe
- 6) National Energy and Climate Plan – Overview of the Opportunities and Challenges (I qasshëm vetëm në anglisht).

Më poshtë do të paraqiten të gjeturat dhe rekomandimet e përmbledhura nga këto publikime të ndara në tre kapituj: Efiçenca e Energjisë, Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë dhe Burimet e Ripërtëritshme.

1. EE-ja në Kosovë – Skemat e Obligueshme për Efiçencë të Energjisë

Zvogëlimi i konsumit të energjisë duke rritur EE si dhe kalimi në BRE është shndërruar në çështje me rëndësi. Kjo shihet si një nga format se si njerëzimi mund të arrijë të ulë konsumin e energjisë nga burimet fosile, të cilat po e shkatërrojnë balancin në tokë. Nga ana tjetër, për Kosovën përmirësimi i EE në ndërtesa është kërkesë urgjente për të arritur zhvillimin ekonomik. Përgjegjësitë kryesore për EE në Kosovë i ka Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), të tjerat Agjencia e Kosovës për Efiçencën e Energjisë (AKEE) dhe disa përgjegjësi të vogla i mban Ministria e Infrastrukturës (MI) dhe Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FFEE).

EE-ja në Kosovë është e rregulluar me një mori dokumentesh, si në vijim:

- 1) Strategjia e Energjisë e Kosovës 2009-2018
- 2) Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
- 3) Plani për Zhvillim të Qëndrueshëm, Shtyllat IV, Trajtimi i Energjisë, Analiza e Politikave/Zyra e Planifikimit Strategjik e Zyrës së Kryeministrit
- 4) Programi i Reformës Ekonomike (PRE) 2016

- 5) Rishikimi i financave publike të Kosovës: Politikat fiskale për një shtet të ri (2014), Raporti nr. ACS9351
- 6) Strategjia e Ngrohjes 2011-2018
- 7) Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012-2021
- 8) Plani Zhvillimor i Shpërndarjes 2010-2014 dhe 2016-2022
- 9) Plani Zhvillimor i Ngrohjes Qendrore - Termokos
- 10) Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014
- 11) Bilanci Afatgjatë i Energjisë 2015-2024.

Pavarësisht këtij fakti, projektet e EE-së nuk kanë pasur shtrirje të gjerë. Kjo mund të jetë për faktin që sektori i EE-së është treg relativisht i ri në Kosovë dhe komuniteti financiar është ende i panjohur me risqet e përfshira në projektet e rinovimit. Tregu është ende në zhvillim, me përvojë dhe aftësi të kufizuara teknike, të zhvillimit të biznesit dhe administrimit të riskut në sektorin e EE, duke i shtuar ende më risqet e perceptuara nga investitorët.

Për këto arsye, një skemë e obligueshme për efikasitet të energjisë (OEE), e dizajnuar në mënyrë të saktë, mund të realizojë me sukses kursime të qëndrueshme të energjisë për shumë vite. Kjo skemë fleksible mund të projektohet në një larmi mënyrash për të përmbushur nevojat kombëtare, dhe për t'u përshtatur në kombinime të ndryshme të politikave. OEE-të janë përdorur për të realizuar kursime kryesisht përmes azhurnimit të stokut të ndërtesave, zëvendësimit të hershëm të pajisjeve jo-eficiente shtëpiake dhe të tjera, si dhe me përmirësimin e proceseve industriale—kursime të efikasitetit të cilat nuk mbulojnë nga standardet dhe rregullimet minimale. Si të tilla, OEE-të sjellin kursime të konsiderueshme të energjisë.

Analiza e INDEP e skemave ekzistuese për OEE tregon se shumica e skemave janë rritur gradualisht dhe në mënyrë të qëndrueshme. Kur qëllimi është të kemi një skemë me shumë palë aktive, rregullat duhet të jenë të thjeshta, transparente dhe të kuptueshme lehtësisht. Në këtë drejtim, OEE-të janë një rrugë e dëshmuar dhe efektive për të dhënë stimuj për masa të verifikuara, me kosto të ulët, në nivel të tregut masiv. Për të përmbushur synimet për kursim të energjisë, shumë vende kanë vendosur që janë të nevojshme politika alternative.

Rekomandimet kryesore për të rritur EE-të janë masat e mëposhtme:

- 1) Zhvillimi i strategjive kombëtare për rinovimin e ndërtesave në përputhje me Direktivën e Performancës Energjetike të Ndërtesave dhe hartimi i udhërrëfyesit dhe udhëzuesit të detajuar për OEE;
- 2) Vendosja e programeve afatgjata të financimit me norma të ulëta interesi për investime në rinovimin, modernizimin dhe ndërtimin e godinave rezidenciale, komerciale dhe publike, me standarde të larta të efijencës dhe përdorim të madh të gjenerimit të shpërndarë nga burimet e ripërtëritshme solare, ngrohjes me biomasë, pompave të nxehtësisë (p.sh. siç është zbatuar në Gjermani nga Kfw);
- 3) Mbështetja e NVM-ve për fabrikimin vendor të teknologjive/pajisjeve me efijencë të energjisë, si dhe të pajisjeve të vogla shtëpiake me energji të ripërtëritshme, për familjet: p.sh. kaldaja efijente me biomasë/biogaz, panele solare të ngrohjes ose pompa ngrohëse/ftohëse;
- 4) Qeveria duhet ta përcaktojë efijencën e energjisë si një prioritet kombëtar të infrastrukturës dhe ta përgatisë një varg të projekteve të duhura të EE në infrastrukturën publike;
- 5) Me krijimin e institucionit të ri (FKEE), AKEE bëhet e tepërt. Rekomandohet që AKEE të sistemohet brenda departamentit të energjisë të MEA, ose të krijohet departamenti i ri i efijencës së energjisë brenda MEA;
- 6) Qeveria ta miratojë rregulloren ESCO dhe pastaj me implementimin e projekteve të ardhshme të EE, FKEE t'i nënshtrohet një kontrate të performances për kursimin e energjisë, e cila do të rezultojë në zhvillimin e tregut ESCO (kompanitë e shërbimit të energjisë) në Kosovë;
- 7) FKEE t'i shfrytëzojë platformat evropiane të EE të tilla si Platforma e de-rrezikimit të Efijencës së Energjisë dhe paketën e marrjes së riskut tek huatë;
- 8) MEA së bashku me Komunat duhet t'i shqyrtojë dhe t'i miratojë të gjitha 38 Planet Komunale për Efijencë të Energjisë (PKEE) si dhe t'i përpilojnë listat e ndërtesave me performancën më të dobët në komunat e Kosovës.
- 9) FKEE përmes një pilot-projekti të jetë "shembull" në krijimin e një ose dy ndërtesave ekzistuese "NZEB" në Kosovë.
- 10) FKEE në vitet e mëvonshme ta zgjerojë fushën e saj për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe ta ndryshojë emrin në "Fondi për Efijencë të Energjisë dhe Eko i Kosovës".

2. Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë i Kosovës

Të gjithë shtetet anëtare të BE-së përgatisin planet e tyre të integruara kombëtare të Energjisë dhe Klimës (NECP). Kryesisht këto planne miratojnë qasje nga poshtë-lart, ku vendet paraqesin përpjekjet dhe kontributet e tyre të drejta dhe ambicioze drejt një sistemi energjetik të dekarbonizuar dhe zbutjes së

ndryshimeve klimatike. Aktualisht, Kosova është në proces të përgatitjes së Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP). Ky plan mbulon periudhën nga 2021 deri në 2030, duke përfshirë një perspektivë për çdo dhjetë vjet deri në 2050, në mënyrë që të sigurojë përputhshmëri me objektivat e politikës përkatëse afatgjata, sipas kritereve të BE-së, UNFCCC dhe Komunitetit të Energjisë.

Meqenëse Kosova është pjesë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe anëtar i përkushtuar i ardhshëm për anëtarësim në BE, Kosova duhet të ndjekë synimet e BE-së dhe të ketë përputhje me legjislacionin e BE-së për energjinë, të cilat synojnë dekarbonizimin e sektorit të energjisë.

Por, më shumë se 91.43% e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë vjen nga djegia e lëndëve djegëse fosile. Edhe pse strategjia e energjisë thotë se të gjitha kapacitetet hidrike do të përdoren deri në vitin 2020 për të arritur synimet e Komunitetit të Energjisë, energjia hidrike përbën vetëm 3% të gjenerimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Ndërsa për energji solare, ende nuk ka ndonjë projekt të rëndësishëm.

Kosova duke marrë shembull vendet anëtare të BE-së, për të arritur objektivat e vitit 2020 por edhe për të mbështetur nivelin e duhur, Kosova ka zbatuar Tarifatat Nxitëse (Feed-in). Kjo skemë ka arritur të tërheqë investitorë të rinj në Tregun e Energjisë, me një kapacitet të instaluar prej 10 MW për energjinë Diellore dhe 33,75 Energjisë së Erës. Por, për shkak të kufizimeve financiare dhe mungesës së një përgjigje të shpejtë ndaj rënies së çmimeve për teknologjinë BRE, efikasiteti i skemave aktuale të mbështetjes është vënë në pikëpyetje. Rrjedhimisht, është krijuar një nevojë për të e konsideruar kthimin në parime stimuluese dhe ankande.

Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë inkorporon këto dimensione:

- 1) Efiçencën e Energjisë,
- 2) Gazrat Serrë / Dekarbonizimin,
- 3) Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë,
- 4) Hulumtimin, Inovacionin dhe Konkurrencën,
- 5) Sigurinë e Furnizimit,
- 6) Tregun e Energjisë.

Deri tash, Kosova ka rikonfirmuar angazhimin e vet për të adresuar çështjet klimatike në potencialin e vet të plotë dhe për të kontribuar në drejtim të synimit kolektiv të Bashkimit Evropian për 40% ulje të emetimeve të gazrave serrë në 2030 krahasuar me nivelet e vitit 1990. Prandaj, miratimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës për Kosovën është mjet drejt afrimit me BE-së dhe tregun e tyre të energjisë. Në rastin e Kosovës dhe anëtarëve të tjerë të Komunitetit të Energjisë, Komuniteti i Energjisë negocion objektivin për uljen e emetimeve deri në vitin 2030 individualisht. Prandaj, objektivi për ne nuk është vendosur ende dhe përcaktimi i rekomandimeve të sakta të politikave nuk është i mundur.

Potenciali i Kosovës për vendosjen e energjisë së ripërtëritshme ndikohet kryesisht nga kufizimet fizike dhe hapësinore, përparimi teknologjik dhe potenciali i burimeve, me disponueshmërinë e burimeve dhe koston e azhurnimit të rrjetit që janë pengesat mbizotëruese për vendosjen e mëtejshme. Burimet e pakta të ujit nuk japin mundësi për prodhimin e hidrocentraleve si burim energjie dhe prodhimi i energjisë nga valët nuk është opsjon për shkak të vendndodhjes gjeografike. Sidoqoftë, potenciali diellor, i erës dhe i biomasës duket të jetë shpresëdhënës. Prandaj, duhet të merret parasysh dhe analizohet kontributi kombëtar i Kosovës për sa i përket pjesës së saj të energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Pasiqë Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë sjell detyrime dhe rregullative të mëtejshme në treg, paraqet mënyrën e vetme që Kosova të mund të ecë përpara drejt një tregu më të integruar të energjisë. Duke zbatuar NECP-në dhe duke synuar zbatimin e marrëveshjes së gjelbër të BE-së, Kosova kanalizon në reformim jo vetëm tregun e energjisë por edhe tërë tregun në tërësi. Duke pasur një fushë të gjerë veprimi, ky plan synon të trajtojë problemet në mënyrë të drejtë dhe të duhur pa sjellë ngarkesa shtesë në tregjet e dobëta.

Qeveria e Kosovës, përkatësisht stafi përgjegjës, ka intensifikuar përpjekjet e tyre në bashkëpunim me donatorët dhe akterët ndërkombëtarë për të zhvilluar këtë plan sa më shpejtë. Edhe pse deri më tani janë bërë përparime, ende duhet të rishikohen disa pika që ky plan të zhvillohet plotësisht. Rekomandimet për këtë plan, janë si vijon:

- 1)** Kosova të përmirësojë më tej koordinimin ndërmjet akterëve të përfshirë. Duke vepruar kështu, Kosova arrin qëndrueshmëri më të mirë të politikave gjatë zhvillimit të planit, por gjithashtu harmonizim të agjendës së zyrtarëve të zgjedhur me ata me rëndësi kombëtare dhe gjithashtu do të rrisim më tej përgjegjshmërinë;
- 2)** Hartimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës duhet të mbështetet nga një angazhim paraprak politik që në fund të fundit sqaron rrugën e Kosovës drejt tranzicionit të energjisë. Ky angazhim duhet ta pozicionojë Kosovën në një udhë të qartë për të arritur objektiva të matshëm në drejtim të tranzicionit të energjisë, klimës, mbrojtjes së mjedisit dhe transformimit të sektorëve në vend;
- 3)** Kërkohet rritje urgjente në investimet më tej në këtë dimension. Sektori i hulumtimit dhe zhvillimit gjithashtu ka ekonomi të lartë të shkallës nëse investohet në bashkëpunim me vendet e tjera të rajonit;
- 4)** Institucionet e Kosovës të marrin në konsideratë konsolidimin e dokumenteve ekzistuese strategjike me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës. Dokumentet ekzistuese strategjike duhet të jenë në përputhje me NECP dhe të integrohen brenda kësaj kornize. Kjo qasje do të ndihmonte në planifikimin më të mirë të politikave në nivelin e qeverisë dhe gjithashtu në monitorimin më të mirë të politikave publike. Procesi i konsolidimit të NECP bashkë me dokumente të tjera strategjike duhet të ketë një konsensus ndërministror të ndjekur nga krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm qeveritar për të monitoruar zbatimin dhe harmonizimin e këtyre politikave;

- 5) Së fundmi, por shumë me rëndësi, duhet të zhvillohet një task-forcë për koordinimin e investimeve të energjisë. Kjo duhet bërë për të koordinuar donatorët e huaj, investimet vendore dhe gjithashtu për të monitoruar zbatimin e planit nga afër, veçanërisht për dimensionet e EE dhe BRE.

3. BRE-të në Kosovë – Ulja e TVSH-së për energjinë solare

Kosova e ka potencialin thelbësor për përvetësimin e instalimeve të FV-ve (fotovoltaike) prej më pak se 10kWp në shtëpitë e banimit. Qeveria e ka miratuar një ligj për njehsimin neto për distributorët e licencuar të energjisë në Kosovë, i cili ua mundëson amvisërive të përfitojnë nga instalimi i sistemeve FV duke i kthyer mbrapsht njehsorët e tyre për energjinë e prodhuar. Për më tepër, mbi 60% e vendit e ka potencialin për të gjeneruar çdo vit 1,387 kWh nga një system 1kWp. Instalimi i një sistemi 5kWp do të rezultonte në faturë neto zero për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, konsumi mesatar vjetor i së cilës në vitin 2019 ishte 4.8MWh energji.

Në skenarët e rritjes prej 20% dhe 40% të çmimit të energjisë, përkatësisht 44 mijë dhe 52 mijë konsumatorë të rinj kanë gjasa që të përvetësojnë sisteme FV - domethënë VAN-i i tyre është pozitiv dhe pika e barazimit në kursimet e faturave është 10 vjet ose më pak. Në këta skenarë, kjo do të nënkuptonte një kapacitet prej 220MW dhe 260MW, përkatësisht, për gjenerim diellor të instaluar në banesa. Sipas çdo skenari, tregu i përgjithshëm potencial i bazuar në tregues racionalë, siç janë VAN dhe pikat e barazimit, tregon se përhapja e FV-ve në mesin e amvisërive banesore duhet të jetë më e konsiderueshme sesa aktualisht. Mungesa e përhapjes më të konsiderueshme të FV-ve tregon se çështja ka të bëjë me arsye jofinanciare.

Pra, mungesa e përhapjes së FV-ve banesore në Kosovë nuk lidhet me arsyet financiare. Përvetësimi i FV-ve në vend është financiarisht i dobishëm për të paktën 29 mijë amvisëri në skenarin më konservator - në skenarë më realistë ka gjasa për deri në 44 mijë përvetësues. Me nivele minimale të depërtimit në treg, instaluesit mund të përfitojnë të paktën 1 milion euro të hyra në vit vetëm nga sektori banesor, me bazë të mjaftueshme konsumatorësh për ta mbështetur biznesin dhe për t'u rritur për dekada. Arsyet e mungesës së përvetësimit të FV-ve duket se lidhen me mungesën e njohurive në treg, sistemet e tregut, vetëdijen për stimujt financiarë dhe opsionet e kredisë, dhe përfshirjen e qeverisë në stimulimin e duhur të sektorit. Sidoqoftë, trajtimi i këtyre barrierave është një detyrë relativisht e lehtë për shkak të mekanizmave tashmë ekzistues në treg (biznesi, subjektet qeveritare të ngarkuara me burimet e ripërtërishme dhe opsionet e kredisë).

Modeli i vlerësimit i ndërtuar për qëllimet e kësaj analize synon të krijojë një mjedis modelimi që merr parasysh disa faktorë kyç në vlerësimin e ndikimit të politikave në përvetësimin e FV-ve nga amvisëritë.

Modeli parashikon vlerësime të përgjegjshme kontekstuale bazuar në kriteret e mëposhtme:

- 1) Madhësia e amvisërisë,
- 2) Lloji i amvisërisë (kompleks banesor apo shtëpi për një amvisëri),
- 3) Të hyrat e amvisërisë,
- 4) Çmimi i energjisë,
- 5) Konsumi i energjisë,
- 6) Politikat stimuluese,
- 7) Kushtet e kredisë,
- 8) Puna nga kompania instaluese,
- 9) Kostoja e instalimit të sistemit 5kWp, si dhe
- 10) Kapaciteti gjenerues i bazuar në statistikën e izolimit për Kosovën.

Tregu i përgjithshëm i shtëpive në Kosovë, struktura e pronësisë dhe normat e shtëpive të banuara tregojnë se ekziston një popullsi e konsiderueshme e pronarëve të shtëpive të veçuara me potencial për të adoptuar FV-të në aspektin e sipërfaqes së tokës në dispozicion dhe pozicionimit të kulmeve. Modelet e konsumit të energjisë nga amvisëritë gjithashtu tregojnë, duke supozuar shpërndarje normale, se në treg janë disa shfrytëzues të mëdhenj rezidencialë të cilët krijojnë shënjestra ideale për instalimin të FV-ve. Aplikimi i vleftësimit të vlerës aktuale neto të kursimeve të faturave të energjisë të sistemit 5kWp tregoi se tregu total i mundshëm i përvetësuesve është i konsiderueshëm.

Studimi tregon se në skenarin pa ndryshime, tregu i përgjithshëm potencial është instalimi i 28,819 sistemeve, ose 144 milionë euro. Kapaciteti total i nënkuptuar i gjenerimit diellor në sektor të banimit do të ishte 144MWp, ose një mesatare e zvogëlimit të kërkesës nga rrjeti prej 212GWh nëse të gjithë e përvetësojnë sistemin FV në vitin e parë. Këto statistika përmirësohen kur llogariten faktorët tjerë potencialisht ndikues, siç janë pritjet reale të inflacionit të çmimeve për shkak të tatimit të karbonit dhe industrisë jokonkurruese të prodhimit të energjisë në Kosovë. Në një skenar me 20% rritje të çmimit, tregu i përgjithshëm i përvetësuesve potencialë ngjitet në 44,767, 88% më shumë nga skenari bazë. Kjo është ekuivalente me një treg të përgjithshëm lokal të shënjestruar prej 223 milionë eurosh, 223 MWp ose një ekuivalent i reduktimit të kërkesës nga rrjeti prej 302GWh. Këto shifra janë edhe më të konsiderueshme në një skenar me 40% rritje të çmimit të energjisë.

Financiarisht, përvetësimi i sistemeve FV është fitimprurës për deri në 14% të amvisërive në Kosovë. Sidoqoftë, mungon mjedisi i informimit rreth përfshirjes së FV-ve brenda shtetit, si dhe sistemet e stimulimit për përvetësim. Në mënyrë që të kapet më mirë tregu i shënjestruar, kërkohen masa

thelbësore të kredisë financiare me një sistem të zhvilluar të tregut, si dhe ndarje efektive të informatave dhe strategjive për gjetjen e klientelës.

Prandaj, rekomandimet janë këto:

- 1)** Ministria e Financave e Kosovës të konsiderojë heqjen e TVSH-së për blerjen dhe instalimin e sistemeve FV me 10 kWp ose më pak (sektori i banimit). Kjo masë do të shërbente për ta stimuluar tregun dhe për t'i siguruar vende të punës të qëndrueshme në industri në të ardhmen e afërt;
- 2)** Instaluesit e FV-ve në Kosovë t'i rrisin në mënyrë proporcionale shpenzimet e tyre për gjetjen e konsumatorëve të ri dhe për sofistikimin në shënjestrimin e sektorit të banimit. Shënjestrimi i duhur i tregut dhe edukimi do ta rrisnin ndjeshëm numrin e përvetësuesve të FV-ve duke parë se është e përshtatshme financiarisht që rreth 23 mijë shtëpi ta bëjnë këtë menjëherë;
- 3)** Bankat tregtare dhe institucionet tjera kredidhënëse të mendojnë për zhvillimin e mëtejshëm të produkteve financiare që synojnë konsumatorët rezidencialë për përvetësimin e sistemeve FV. Duke punuar së bashku me IFN-të që aktualisht janë në treg, Qeverinë e Kosovës dhe instaluesit, gjithashtu duhet t'i eksplorojnë rrugët e reklamimit të këtyre kredive;
- 4)** Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me bizneset e instalimit të FV-ve si dhe OJQ-të, ta shtojnë fokusin në edukimin e publikut në lidhje me përfitimet e sistemeve FV dhe përfitimet moderne, reale, financiare. Kjo mund të sjellë reduktim deri në 400GWh të kërkesës në 40 vitet e ardhshme.



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit “Promovimi i Efiçencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme në Kosovë” i mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Efiçencë të Energjisë. Pikëpamjet e hartuesit të këtij dokumenti si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

